Kronikë

VIDEO/ Shpërthim me tritol në banesën e efektivit në Shkodër, e gjithë familja ishte brenda! Dëshmia në polici: Nuk kam konflikte me askënd

Tritoli në banesë, automjet apo biznes është paralajmërimi që po përdorin autorët për pronarët, me të cilët mund të kenë pasur konflikte të mëparshme. Rasti i fundit është mbrëmjen e djeshme në Shkodër, rreth orës 02:25 kur në banesën e efektivit të policisë Pëllumb Vuka shpërtheu lënda plasëse. Brenda një muaji, 4 oficerë policie në Shkodër kanë rënë pre e sulmeve me tritol dhe djegie të makinave.

Redaksia
2 Qershor, 07:10 | **Përditesimi i fundit: 2 Qershor, 08:30**

Tritoli në banesë, automjet apo biznes është paralajmërimi që po përdorin autorët për pronarët, me të cilët mund të kenë pasur konflikte të mëparshme. Rasti i fundit është pas mesnatës së djeshme në Shkodër, rreth orës 02:25 kur në banesën e efektivit të policisë Pëllumb Vuka shpërtheu lënda plasëse.

Pranë murit të banesës në fshatin Hot i Ri, shpërtheu tritoli. Banesa ishte në pronësi të 49-vjeçarit, oficer policie në Komisariatin e Policisë Shkodër. Për pasojë ka vetëm dëme materiale në banesë, si dhe është dëmtuar edhe mjeti i tij tip Benz, i parkuar para banesës. Në momentin e shpërthimit ka qenë në shtëpi së bashku me familjen. Pista kryesore e hetimit të shpërthimit me tritol është për shkak të detyrës. Në dëshminë e parë të dhënë para kolegëve, Vuka ka deklaruar se nuk ka konflikte me persona të tjerë.

LEXO EDHE:
Grabitësit lidhin çiftin e të moshuarve dhe i plaçkisin banesën në Vermosh! Gruaja rrëfen tmerrin: Hynë brenda me automatikë, na morën 30 mijë euro dhe makinën

Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, po punon për zbardhjen dhe sqarimin e plotë të kësaj ngjarjeje, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve.

Ky është rasti i katërt brenda pak javësh që oficerët e policisë së Shkodrës bien pre e sulmeve. Më 20 maj, u vendos tritol në lokalin në pronësi të efektivit **Ndrek Rrasa**, 46 vjeç.

Konkretisht më 27 prill u dogj makina e Dritan Turhanit në lagjen Perash ndërsa më 14 maj makina e Sokol Kroni në lagjen "Tre Heronjtë". Të gjitha këto ngjarje pa autorë! Duket se qëllimi i tyre nuk është të kryejnë vrasje por të paralajmërojnë efektivët për ndonjë përplasje që mund të kenë pasur më parë që shpesh herë vjen për shkak të detyrës. Edhe në qytete të tjera ka pasur shpërthime me tritol në automjete apo biznese për pronarët, por gjithçka ka qenë vetëm me dëme materiale.

Dëmet e shkaktuara nga shpërthimi i tritolit

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 08:18

I vunë tritol në banesë, dëshmia e policit para kolegëve: Nuk kam konflikte me askënd



Ky është Pëllumb Vuka, oficeri i krimeve në komisariatin e policinë e Shkodrës që iu vu tritol gjatë orës 2 të natës. Në momentin e shpërthimit ka qenë në shtëpi së bashku me familjen.

Pista kryesore e hetimit është për shkak të detyrës. Në dëshminë e parë të dhënë para kolegëve, Vuka ka deklaruar se nuk ka konflikte me persona të tjerë.

Ora 07:56

Policit i hedhin 'shtëpinë në erë' në Shkodër, pamjet e banesës së shkatërruar

Report Tv ka siguruar pamjet e shpërthimit me tritol në banesën e efektivit të policisë së Shkodrës, Pëllumb Vukaj. Duket qartë dëmi i madh që ka shkaktuar lënda plasëse pasi është shembur një pjesë muri dhe janë thyer xhamat e dyert e banesës. Edhe automjeti është tërësisht i shkatërruar. Nuk dihet ende sa ishte sasia e tritolit të hedhur, por ka shkaktuar tronditje të madhe në banesë.

A.M./Shqiptarja.com

TAG: pellumb vuka | tritol | Shkoder

Komento

Komente

Lala: 02/06/2022 12:12
Do ken ngatrru shpi se ska munci ahahahah.pallosh
Përgjigju

Shkodra: 02/06/2022 09:51
Nuk le gru a vajz pa ngacmu e gjob pa vu o i poshter ! Djali prej ne kamarier te fontana u ba me dy lokale me cfar leksh ???????? Me lek bakshishesh ????
Përgjigju

Si mor pellumb ske konflikte: 02/06/2022 08:34
Ai djali jot nga kamarier u ba pronar i dy lokaleve ku i gjeti lekt ??? Me lekt qe ven gjoba ti u ba dihet . Hapeni bethesh neper shkoder e shpin e paskeni kaçorr
Përgjigju

Drini: 02/06/2022 07:35
Zoti i ruajte shqiptaret , se do vije dita qe dhe policine do e japim me koncesion meqe keta tanet jane te zhytur ne batak nga i pari deri tek i fundit. Meqe ra fjala policia e Shkodres si eshte me realizimin e planit te gjobave per makinat ?
Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Shqipëria ndalon përdorimin e qeseve plastike njëpërdorimshe, a jeni dakord me vendimin?
PO | JO | NUK E DI

Lajme të tjera

Kronikë

'Në lokal, me armë me vete e municion luftarak', arrestohet 43-vjeçari në Shkodër
2 Qershor, 09:43

Sport

Shkodra pa gjumë, futbollistët e Vllaznisë pritet si heronj! Presidenti Xhaferri: Jemi të veçantë
1 Qershor, 12:18

Kronikë

Kishte bërë gati 4 kallëpe tritoli për t'i shitur, arrestohet 19-vjeçari në Durrës (EMRI)
1 Qershor, 08:58

Kronikë

Gjendet e vdekur 37-vjeçarja në një livadh në Shkodër! Prej 23 ditësh e larguar nga banesa (VIDEO)
31 Maj, 17:40

Kronikë

Del FOTO/ Humbën jetën pasi ranë në kontakt me energjinë elektrike në dush, kush është mamaja dhe dy vajzat që vdiqën në Fushë-Arrëz
30 Maj, 09:51

Kronikë

I vihet tritol makinës luksoze në Vlorë, menaxheri i kazinosë së kompleksit 'Marina bay': Nuk kam konflikt me njeri (VIDEO)
30 Maj, 07:18

Kronikë

Operacioni për drogë në Dukagjin, përveç efektivit që ra në humnerë, i plagosur edhe një koleg i tij! Policia s'e raportoi, Ambasada e SHBA-së e 'nxjerr zbuluar'
29 Maj, 09:44

Kronikë

Bien në kontakt me energjinë elektrike, vdes nëna me dy vajzat në Fushë-Arrëz! Njëra po lahej në dush, e ëma dhe motra i shkuan për ndihmë! Plagoset djali
28 Maj, 17:36

Kronikë

Kontrollet për drogë në Dukagjin, nënkomisari bie në humnerë, nxirret pas 12 orësh! Dështon helikopteri shqiptar, KFOR dërgon policin te Trauma! VIDEO nga momenti shpëtimit
28 Maj, 10:36

Kronikë

Plagosi 11 vjeçarin me armë zjarri, arrestohet i riu në Lezhë
27 Maj, 22:48

Kronikë

Zbulohet një 'fermë' kriptomondhash në Shkodër, sekuestrohen 16 pajisje! Vihet në pranga 43-vjeçari, në kërkim një i ri
27 Maj, 15:30

Kronikë

Prag tragjedie në Pukë, 17-vjeçari plagos me armë një 11 vjeçar, objektiv kishte kushëririn e tij! I mituri me urgjencë drejt Tiranës! Policia në kërkim të autorit
26 Maj, 16:32

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje